



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 27 datë 26-02-2026

**PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TË VITIT 2025 TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2025 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2026, duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimit nr. 127 datë 19.12.2025 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025”, Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 14.1.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, Aktit normativ nr. 10 datë 8.10.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, Aktit normativ nr. 1 datë 19.12.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, në Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve me shkresën nr. 764 prot., datë 19.12.2025, në kuadër të grandit të performancës, Bashkia Korçë, VKM nr. 104 datë 11.2.2026 “Për një ndryshim në VKM nr. 419 datë 26.6.2024 , Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, VKM nr. 103 datë 11.2.2026 “Për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.5.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e NJVV, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV, të ndryshuar”, si dhe VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë të ardhurat e trashëguara të vitit 2025 në buxhetin e vitit 2026 sipas burimeve të financimit në vlerën **263,112,047.59 lekë**, si më poshtë:

Emërtimi I institucionit	Të ardh e trashëguara	Të ardh e trashëguara	Të ardh e trashëguara	Të ardh e trashëguara	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	Të ardhurat nga sponsorizimet	Total
	tr pak sekt	grand	grand sipas AN	gr performances			

Tabela nr. 2 Tabela e të ardhurave të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar dhe përdorimi i saj në buxhetin e vitit 2026.

Tabela nr. 3 Tabela e të ardhurave të trashëguara nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe përdorimi i tyre në buxhetin e vitit 2026.

3. Të miratojë shpenzimet sipas programeve dhe Institucioneve në vlerën **263,112,047.59 lekë**, sipas tabelës nr. 6 bashkangjitur, Tabela përmbledhëse e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2025 në buxhetin e vitit 2026, Shpenzimet e Bashkisë sipas klasifikimeve buxhetore.
4. Detajimi i shpenzimeve korrente dhe investimeve nga të ardhurat e trashëguara të vitit 2025 në buxhetin e vitit 2026, sipas tabelave të mëposhtme, do të bëhet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
Tabela nr. 4 Matrica e shpenzimeve korrente dhe produkteve sipas programeve
Tabela nr. 5 Matrica e shpenzimeve për investime dhe produkteve sipas programeve
5. Efektet financiare të zbatimit të VKM-ve, fillon nga 01.01.2026.
6. Të miratojë ndryshimin e masës së shpërblimit mujor në vlerën 26,650 lekë për këshilltarët, 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë (266,500 lekë), si rezultat i zbatimit të VKM 103 datë 11.2.2026.
7. Të miratojë ndryshimin e masës së shpërblimit për kryetarët e fshatrave (kryepleqtë), në masën 10% të pagës së Administratorit, si rezultat i zbatimit të VKM 103 datë 11.2.2026.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 6
Vota Abstenim 1
Zbardhur më datë 26-02-2026

